


AKTI I THEMELIMIT
I
I SHOQERISË ANONIME ME OFERTË PRIVATE
“ABEL ENERGY ALBANIA” SHA

Themeluesit që nënshkruajnë më poshtë:

1. *Shoqeria “B93 II” sh.p.k.*, me nr. NIPT-I **L522090500**, perfaqesuar nga administratori i shoqerise, **Z.Ardit Liçaj**, atesia Shpetim, i datelindjes 05.03.1990, lindur ne Ballsh, i pajisur me leternjoftime numer personal **J00305109G** shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar
2. *Shoqeria “Shendelli” sh.p.k.*, me nr. NIPT-i **K07924803N**, perfaqesuar nga administratori i shoqerise, **Z. Yzedin Bozhaj**, datelindjes 20.01.1960, lindur ne Fier, i pajisur me leternjoftime numer personal **G00120183L** shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar.
3. **Aurel Byberi** , datelindjes 28.01.1985, lindur ne Bajram Curri, i njohur prej meje noteres, i pajisur me leternjoftime numer personal **I50128082V**, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar,
4. **Akil Doçi**, shtetas shqiptar, i biri i Ibish, lindur me 04.02.1986 ne Bajram Curri, Tropoje e banues ne Durres, mbajtes i leternjoftimit me nr. 032523340 dhe nr. personal I60204078P, madhor me zotesi te plote juridike per te veprua.
- 5.

duke u bazuar në Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” dhe Aktin e Themelimit, vendosën të miratojnë Aktin e Themelimit të shoqërisë tregtare me ofertë private “ABEL ENERGY ALBANIA” SHA, si më poshtë vijon:



Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i veprimtarisë.

1. Shoqëria tregtare **“ABEL ENERGY ALBANIA” SHA** ka si objekt te veprimtarisë se saj:

Investime dhe shërbime në fushën e prodhimit të energjisë elektrike, shitjes, ndertim HEC, dhe cdo veprimtari e lidhur me të, ndertim, projektim, rikonstruksion ndertime civile, ekonomike, industriale dhe turistike, ndertime rrugësh, vepra hidroteknike etj. Prodhim e tregtim të energjisë elektrike, materialeve të ndertimit, Tregtim makinerie e pjese kembimit për llojet e ndryshme të makinerive në funksion të veprimtarisë së saj, si dhe import-eksportin e tyre.. Përfaqesim Brandi të huaj- Zhvillimi rrjeti shitjeje si dhe shitje nepermjet internetit(online). Hoteleri turizem dhe gjithçka të lidhur me këto fushe me qëllim krijimin e kushteve të favorshme për ecurin e biznesit edhe pas themelimit edhe pse nuk janë parashikuar specifikisht në statut. Shoqëria ka për objekt import- eksportin, prodhimin, industrializimin dhe tregtimin e të gjitha produkteve të dëshiruara që nuk bien ndesh me asnjë.

Ligj, qofte drejtperdrejt ose përmes paleve të treta, kryesisht mallra e produkte të nevojshme për kryerjen e aktivitetit ekonomik e përbushjen e objektivave. Si pjesë e aktivitetit të saj shoqëria mund të financojë pale të treta, ose mund të marrë financime dhe të kryej ndërmjetësime dhe brokerime të cdo lloji, në nivel ndërkombëtar. Bashkpunimi me kompani e subjekte të të njëjtes fushe si dhe ndërmjetësime konsulencia për vendosjen e shoqërive të huaja në Shqipëri.

2. Objekti i aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.

Neni 2. Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

- 2.1. Asambleja e Aksionareve vendosi që shoqërinë ta emërtojë:

“ABEL ENERGY ALBANIA” SHA

- 2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga “Ismail Qemali, Pallati Nr.3/162, Kati 4-t, Ap.10

- 2.3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3. Regjimi juridik







- 3.1. Shoqëria është shoqëri aksionare. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.
- 5.2. Me vendim të saj, Asambleja e Aksionereve emëron Këshilli Mbikqyrës të shoqërisë , i cili do të përbehet nga 5 (pesë) persona, një prej tyre do të jetë Kryetar i Këshillit mbikqyrës.
- 5.3. Asambleja e Ortakëve me kërkesën e saj drejtuar Këshilli Mbikqyrës, nëpërmjet vendimit të bordit drejtues mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Këshilli Mbikqyrës do të përshtatë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në organet kompetente shqiptare.
- 5.4. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.
- 5.5. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

Neni 4 . Të drejtat e Shoqërisë dhe të Aksionareve

- 4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqëria ka të drejtë të marre pjesë si ortakë/akionare në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.4. Me fitimin e personalitetit juridik Shoqëria bëhet përgjegjëse kundrejt palëve të treta për detyrimet dhe dëmet që shkakton gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj. Aksionarët e shoqërisë do të jenë përgjegjës kundrejt palëve të treta deri në shumën e kontributit të derdhur në kapitalin aksionar.
- 4.5. Aksionarët kanë të drejtë të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.



4.6. Aksionaret kanë të drejtë të marrin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogarite ekonomike etj.

4.7. Aksionaret të cilët vendosin të shesin kuotat e tyre pjesërisht apo tërësisht detyrimisht do duhet t'ja ofrojnë fillimisht atë aksionarëve të tjerë të kësaj shoqërie.

Transferimi i aksioneve tek të tretët është i kushtëzuar nga e drejta e parablerjes me të njëjtat kushte, e drejtë e cila duhet të ushtrohet brenda 2 (dy) muajsh nga marrja e njoftimit të drejtuar aksionarëve të kësaj shoqërie, me postë rekomande, me vërtetim marrje, mbi shitjen e dëshiruar dhe kushtet e paraqitura. Mosrespektimi i kësaj dispozite e bën shitjen të pavlefshme.

Çdo vendim për shitjen e aksioneve do duhet të marrë miratim paraprak dhe pëlqimin nga të gjithë anëratët e Këshillit Mbikqyrës dhe asamblesë së aksionarëve.

Neni 5. Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të aksionarëve, sipas dispozitave të Statutit të Shoqërisë.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Shoqëria tregtare "ABEL ENERGY ALBANIA" SHA do të fillojë veprimtarinë e saj me një kapital themeltar prej 5.000.000 (pesë milion) Lekë, e cila zotërohet tërësisht nga aksionarët.

6.2. Pjesëmarrja e aksionarëve vetëm në kapitalin themeltar të shoqërisë është :

A. Shoqëria "B93 II" sh.p.k., zotëron 1000 (njëmijë) aksione, me vlerë 1.000.000 (një milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 20% (njetzetë) të aksioneve.

B. Shoqëria "Shendelli" sh.p.k zotëron 1000 (njëmijë) aksione, me vlerë 1.000.000 (një milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 20% (njetzetë) të aksioneve.

C. Aurel Byberi , zotëron 2000 (dymijë) aksione, me vlerë 2.000.000 (dy milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 40% (dyzetë) të aksioneve.






D. Akil Doçi zotëron zotëron 1000 (njëmijë) aksione, me vlerë 1.000.000 (nje milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 20% (njetetë) të aksioneve.

6.3. Kapitali është i ndarë në 5000 (pesë mijë) aksione të zakonshme me vlerë nominale 1.000 (një mijë) Lekë secili.

Kreu IV ORGANET E SHOQËRISË

Neni 7

7.1. Vendimet në Shoqëri merren nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë në mënyrë unanime. Këto vendime shënohen në regjistrin përkatës.

7.2 Administratori i Shoqërisë do të vendoset nga Asambleja e Aksionarëve dhe çdo vendim merret në mënyrë unanime.

7.3 Asambleja e Përgjithshme ka vendosur që administratori i parë i shoqërisë të jetë z.**Albert Bozhaj**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar me një mandat 3 (tre) vjeçar nga data 25.05.2021 deri 25.05.2024 dhe raporton tek Këshillit Mbikqyrës mbi mbarëvajtjen e shoqërisë.

7.4 Eksperti kontabël i autorizuar caktohet nga Asambleja e Ortakëve.

7.5 Anëtarët të Këshillit Mbikqyrës emërohen:

- Shpëtim Liçaj
- Joana Bozhaj (Çuko)
- Jehona Rexhaj
- Eranda Byberi
- Jehon Breçani

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Mbikëqyrës është 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Z. Shpëtim Liçaj emërohet Kryetar i Këshillit të Mbikëqyrës, detyrë të cilën do ta ushrojë gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të saj si anëtar.



**Kreu V
ADMINISTRIMI**

Neni 8

8.1 Administrimi i Shoqërisë do të bëhet në përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

**Kreu VI
DISPOZITA TË TJERA**

Neni 9

9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqëria, mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t'i mbetet aksionarëve të shoqërisë në përputhje me pjesët e tyre takuese.

9.2. Ky Akt shtypet dhe firmoset në 6 (gjashtë) kopje, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

9.3. Aksionaret bien dakord që pasi shoqëria të realizojë të ardhura të fillojë menjëherë shlyerjen e detyrimeve ndaj furnitorëve apo shoqërive nënkontraktore në mënyrë kronologjike sipas faturave apo kontratave të nënshkruara midis tyre dhe gjithë detyrimet e tjera që rrjedhin për qellimin e investimit.

**AKSIONARËT THEMELUES TË SHOQËRISË TREGTARE
"ABEL ENERGY ALBANIA" SHA**

Aksioneri : Shoqëria "B93 II" sh.p.k. perfaqësuar nga Ardit Liçaj

Ardit Liçaj

Aksioneri : Shoqëria "Shendelli" sh.p.k perfaqësuar nga Yzedin Bozhaj

Yzedin Bozhaj

Aksioneri : Aurel Byberi

Aurel Byberi

Aksioner : Akil Doçi

AKIL DOÇI

Themeluar Tirane me 25/05/2021